



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 135/Prot.

Tiranë, më 12.06.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datë 12.06.2020, ditën e premte, ora 13.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në platformën online, përmes lidhjes Zoom, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli u mbledh në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahimi
2. Z. Alfred Balla
3. Znj. Esmeralda Keshi
4. Z. Tartar Bazaj
5. Z. Bujar Sheshi
6. Z. Kosta Beluri
7. Z. Sandër Beci
8. Z. Vatë Staka

Mungon znj. Nurihan Seiti.

Ishin ftuar për të qenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT, EURALIUS dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z.Gent Ibrahimi, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kaloi në paraqitjen e rendit të ditës.

Rendi i ditës:



1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datave 15.05.2020, 19.05.2020 dhe 21.05.2020
2. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Drini Pali.
3. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokuroren Rabiana Halili.
4. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokuroren Elsa Miha.
5. Miratim i projektaktit për angazhimin e prokurorit Ylli Pjetërnikaj në veprimtari jashtë funksionit (mësimdhënie).
6. Miratimi i projektaktit për angazhimin e prokurores Doloreza Musabelliu në veprimtari jashtë funksionit (eksperte pranë OSBE, trajnere).
7. Miratimi i projektaktit për angazhimin e prokurores Manjola Kajana në veprimtari jashtë funksionit të prokurorit, si eksperte pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara kundër Drogërave dhe Krimit të Organizuar (UNODOC).
8. Miratimi i projektaktit për mbarimin e statusit, për shkak dorëheqjeje, të magjistratit z.Nezir Gjoka, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
9. Hedhja e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankesave kundër arkivimit të hetimit nga ana e ILD-së.
10. Prezantimi i projektregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionet e drejtuesit të prokurorisë”.
11. Raportimi nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale për ecurinë e procesit të verifikimit të figurës, pasurisë si dhe plotësimin e kushteve dhe procedurave të parashikuara nga ligji, për kancelarët në detyrë në sistemin e prokurorisë si dhe për kandidatët për inspektorë në ILD.
12. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime). Diskutime rreth mundësisë për transferim të përkohshëm të një prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë-Pogradec, si dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë - Kukës.

Z. Ibrahim i fillon mbledhjen me pikën e shtatë të rendit të ditës, pasi relatorja përkatëse ka kërkuar leje të largohet nga mbledhja, para kohe.



- *Miratimi i projektaktit për angazhimin e prokurores Manjola Kajana, në veprimtari jashtë funksionit, si eksperte pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara kundër Drogërave dhe Krimit të Organizuar (UNODOC).*

Z. Ibrahim i jep fjalën znj. Keshi, për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Znj. Keshi relaton se, më datë 02.06.2020, prokurorja Manjola Kajana ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kërkesën për t'u lejuar të punojë për periudhën 01.07.2020 – 30.10.2020, si eksperte ligjore për llogari të Zyrës së Kombeve të Bashkuara kundër Drogërave dhe Krimit të Organizuar (UNODOC), veprimtari kjo e parashikuar nga neni 278 dhe neni 278/a i Kodit Penal. Agazhimi i saj në kuadër të këtij projekti, do të jetë jashtë orarit të punës. Sipas vërtetimit të lëshuar nga drejtuesja e Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, dhe drejtuesi i SPAK-ut, ku kjo prokurore është caktuar dhe ushtron detyrën, ngarkesa e saj e punës përputhet me ngarkesën e tetë prokurorëve të tjerë. Komisioni, pas verifikimeve të bëra, ka arritur në përfundimin se kjo prokurore nuk është subjekt i ndonjë mase disiplinore në fuqi. Komisioni vlerëson se ushtrimi i kësaj veprimtarie, në masën dhe kohën e kërkuar, nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së saj si prokurore. Në këto kushte, Komisioni ka arritur në përfundimin se dosja për këtë prokurore është e plotë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit, prandaj dhe i propozon Këshillit miratimin e kësaj kërkesë.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.

Z. Ibrahim vijon me leximin e projektaktit si më poshtë:

Bazuar në nenin 143 të Kushtetutës, nenin 9 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 189/1 pika “c” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë; në Vendimin nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese; nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, të miratuar me Vendimin nr.26, datë 22.02.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren Manjola Kajana, si eksperte pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara kundër Drogërave dhe Krimit të Organizuar (UNODOC), zyra në Vjenë, Austri, në kuadër të projektit “Programi Global Kundër Armëve” (Global Firearms Programe). Qëllimi është përgatitja e një përmbledhjeje me raste të praktikës gjyqësore për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje e armëve dhe municioneve”, parashikuar nga nenet 278 dhe 278/a të Kodit Penal, si dhe për të rishikuar



në gjuhën shqipe, dokumentin “Udhëzues mbi provat elektronike”, të përgatitur nga UNODOC. Veprimtaria do të ushtrohet jashtë orarit të punës, për periudhën 01.07.2020-30.10.2020.

2. Të njoftohet për këtë vendim prokurorja Manjola Kajana dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë - Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. *(Vendimi i plotë ndodhet në dosjen e mbledhjes plenare si dhe i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).*

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 9 vota pro, pasi në këtë moment, mbledhjes plenare i bashkohet edhe znj. Seiti.

Z. Ibrahim vijon me çështjen e dytë të ngjashme, që ishte parashikuar si pika e gjashtë e rendit të ditës.

- *Miratimi i projektaktit për angazhimin e prokurores Doloreza Musabelliu në veprimtari jashtë funksionit (si eksperte-trajnere pranë Zyrës së OSBE-së, Tiranë).*

Z. Ibrahim i jep fjalën znj. Keshi.

Znj. Keshi relatton se, më datë 02.06.2020 prokurorja Doloreza Musabelliu ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kërkesën për t’u lejuar të ushtrojë veprimtari jashtë funksionit, në cilësinë e ekspertes ligjore për llogari të Zyrës së OSBE-së, Tiranë, për periudhën 29.05.2020-30.10.2020. Angazhimi i saj do të jetë jo më shumë se dy orë në javë, gjatë orarit zyrtar, dhe pa kufizim, jashtë orarit zyrtar. Sipas vërtetimit të drejtuesit të SPAK-ut, ngarkesa e saj në punë është më e ulët se mesatarja e ngarkesës së prokurorëve të tjerë të seksionit ku ajo ushtron detyrën. Nga ana e burimeve njerëzore është verifikuar fakti, se nuk ka masa disiplinore në fuqi. Ushtrimi i kësaj veprimtarie jashtë funksionit nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së saj si prokurore, prandaj Komisioni i propozon Këshillit që ta miratojë këtë kërkesë.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.

Z. Ibrahim vijon me leximin e projektaktit, pa iu referuar bazës ligjore, pasi rasti është i njëjtë me atë të prokurores Kajana. Në këto kushte, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, vendosi:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren Doloreza Musabelliu, si eksperte pranë OSBE, Tiranë, në kuadër të trajnimit që kjo organizatë do të organizojë në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, në masën jo më shumë se dy orë në javë gjatë orarit zyrtar,



dhe pa kufizim jashtë orarit zyrtar, deri më datë 30.10.2020 (*Vendimi i plotë ndodhet në dosjen e mbledhjes plenare si dhe i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit*).

Z. Sheshi komenton votën e tij “pro”, për prokuroren Musabelliu, duke theksuar faktin që pjesëmarrja në këtë projekt nuk e cënon profilin e punës së saj në SPAK. Ndërkaq, ai sugjeron që Këshilli ta ketë parasysh këtë fakt në të ardhmen dhe ky rast të jetë përjashtim, pasi nga prokurorët pritet përkushtim maksimal në punën e tyre. Pritshmëritë ndaj prokurorëve të SPAK-ut janë për angazhimet në kryerjen e detyrës dhe jo për mësimdhënie.

Z. Ibrahim e vlerëson pozitive kujtesën e z. Sheshi. Teksa sqaron se të gjithë magjistratët kanë të drejtën e tyre kushtetuese për t’u përfshirë në veprimtari jashtë funksionit (në formën e mësimdhënies), ai shprehet se Këshilli është i detyruar të kryejë verifikimet përkatëse lidhur me ngarkesën e punës së prokurorëve dhe performancën e tyre. Është në të drejtën e Këshillit që të mbajë qëndrim në raport me një kategori të caktuar prokurorësh, kundrejt të dhënave të sugjeruara nga statistikat.

Z. Ibrahim vijon me çështjen e tretë të ngjashme, parashikuar në pikën e pestë të rendit të ditës.

➤ *Miratimi i projektaktit për angazhimin e prokurorit Ylli Pjetërnikaj në veprimtari jashtë funksionit (mësimdhënie).*

Z. Ibrahim i jep fjalën znj. Keshi, për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Znj. Keshi relatton se, më datë 08.05.2020 prokurori Ylli Pjetërnikaj ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kërkesën për të ushtruar veprimtari jashtë funksionit, në detyrën si pedagog me kohë të pjesshme në dy institucione të arsimit të lartë dhe konkretisht: pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në masën e dy orëve në javë, çdo të mërkurë, nga ora 14.00 deri në orën 16.00, për vitin akademik 2020-2021; dhe pranë Fakultetit të Drejtësisë, Kolegji Universitar i Biznesit (TBU), në masën 60 orë të shpërndara në 30 javë (15 orë për çdo semestër), pra, deri në dy orë në javë, çdo të enjte, pas orës 17.30, për vitin akademik 2020-2021.

Pagesa për ushtrimin e kësaj veprimtarie pranë Universitetit të Tiranës është në përputhje me VKM nr.268, datë 29.03.2017. Sipas vërtetimit të lëshuar nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë - Lezhë, deri më datë 21.05.2020, prokurori Pjetërnikaj ka patur për shqyrtim vetëm katër materiale hetimore. Kjo ngarkesë justifikohet me faktin se, më 26.04.2020, këtij prokurori i ka mbaruar caktimi i përkohshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë - Tiranë. Komisioni, pas verifikimeve të bëra, arriti në përfundimin se ky prokuror nuk është subjekt i ndonjë mase disiplinore në fuqi. Komisioni vlerëson që ushtrimi i kësaj veprimtarie, në masën dhe në kohën e kërkuar, nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror. Në këto



kushte, Komisioni vlerëson që dosja për këtë prokuror është e plotë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit, prandaj dhe i propozon Këshillit që ta miratojë këtë kërkesë.

Z. Ibrahim vlerëson punën e bërë nga Komisioni për përcaktimin e saktë e të hollësishëm të orëve të veprimtarisë jashtë funksionit të prokurorëve si dhe kufijtë e lejeve që Këshilli jep për ta. Në kushtet e uljes së numrit të prokurorëve, e drejta e tyre për të ushtruar këtë veprimtari jashtë funksionit, të kufizohet në kufijtë që lejon ligji.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështjeje, u diskutua:

Z. Bazaj shprehet se anëtarët e Komisionit duhet t'u kërkojnë informacion më të hollësishëm drejtuesve të prokurorëve, sa i përket ngarkesës së dosjeve dhe gjendjes reale të tyre. Ai tërheq vëmendjen që Komisioni të tregohet më i kujdesshëm, sidomos për kërkesat e prokurorëve që vijnë nga rrethet, për shkak të kohës që atyre u duhet të vijnë deri në Tiranë. Praktikisht, ne nuk po japim leje vetëm për dy orë, por edhe për kohën që atyre u duhet për të udhëtuar. Parimisht, ai pajtohet me dhënien e lejes, por thotë se, në të ardhmen, Këshilli duhet të mbajë parasysh faktin e kohëzgjatjes së saj, tej kufijve që lejon ligji.

Z. Balla shprehet se i vetmi problem në rastin e prokurorit Pjetërnikaj, është veçoria që ai kërkon leje për mësimdhënie njëkohësisht në dy fakultete të ndryshme, ndërkohë që sipas dispozitave të Rregullores së Posaçme të Këshillit, brenda një viti akademik, prokurorët duhet të japin mësim vetëm në një fakultet. Në dispozitat tranzitore të Rregullores, Këshilli e ka kundërshtuar këtë dhe ka vendosur që ky kriter nuk ndiqet për veprimtarinë jashtë funksionit. Sa i përket shqetësimit të z.Bazaj, Komisioni u ka kërkuar të gjithë prokurorëve të vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e përcaktuar nga ligji dhe nga Rregullorja e Këshillit.

Z. Ibrahim e vlerëson të rëndësishme kujtesën që bën z. Bazaj, pasi, kur llogarisim angazhimin e prokurorëve, duhen mbajtur parasysh edhe gjëra të tilla, si orët e udhëtimit, orët e përgatitjes etj. Por, Komisioni i ka trajtuar të gjithë komponentët në relacion dhe ka arritur në përfundimin që kjo veprimtari nuk cënon ecurinë e punës si prokuror. Në rastin e prokurorit Pjetërnikaj, në projektakt është propozuar pika 1, ku shprehet për vlerën e pagesës për këtë aktivitet, propozon që kjo pikë të hiqet duke u unifikuar me dy vendimet e mësipërme.ka një papajtueshmëri lidhur me pagesën, ai propozon që kjo frazë të hiqet.

Z. Ibrahim vijon me leximin e projektaktit si më poshtë, pa iu referuar bazës ligjore, si rast i njëjtë me dy rastet e sipërcituara.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi si më poshtë:



1. Miratimin për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit (mësimdhënie) për prokurorin Ylli Pjetërnikaj, si pedagog me kohë të pjesshme pranë Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në masën dy orë në javë, çdo ditë të Mërkurë, nga ora 14.00 deri në orën 16.00, për vitin akademik 2020-2021.

2. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit (mësimdhënie) për prokurorin Ylli Pjetërnikaj, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Kolegji Universitar i Biznesit, Tiranë (TBU), deri në dy orë në javë, çdo ditë të enjte, pas orës 17.30, për vitin akademik 2020-2021.

3. Të njoftohet për këtë vendim prokurori Pjetërnikaj dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. (*Vendimi i plotë ndodhet në dosjen e mbledhjes plenare, si dhe i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit*).

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 9 vota pro.

Z. Ibrahim njofton se znj. Keshi do të largohet nga mbledhja për arsye familjare dhe riqartëson se kjo ishte arsyeja që Këshilli bëri kapërcim në rendin e ditës. Duke iu rikthyer pikës së parë të rendit të ditës, ai sqaron se procesverbalet u janë shpërndarë anëtarëve në kohën e duhur.

➤ *Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datave 15.05.2020, 19.05.2020 dhe 21.05.2020*

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e procesverbaleve të sipërcituara.

Miratohen me 8 vota, pasi znj. Keshi është larguar.

Z. Ibrahim vijon me pikën e katërt të rendit të ditës.

➤ *Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokuroren Elsa Miha.*

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Beluri, për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Z. Beluri relatton për prokuroren Elsa Miha, duke përmendur se në raportin profesional për këtë prokurore, Komisioni ka analizuar formularin e vetëdeklarimit, tre aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, pesë aktet e shortuara dhe të gjithë informacionet e ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nga prokuroritë e rretheve.



Gjatë periudhës së rivlerësimit, kjo prokurore ka ushtruar funksionin në prokurorinë e rrethit Tiranë dhe rrethit Fier. Meqenëse, periudhën më të gjatë kohore e ka kaluar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë - Tiranë, shorti për këtë subjekt është hedhur në këtë prokurori. Në raport janë analizuar të gjithë ankesat, mosfillimet apo problematikat e ardhura nga institucionet përkatëse.

Z. Beluri kërkon ndjesë për vonesën e paraqitjes së raportit, duke sqaruar se kishte një emergjencë të ardhur nga KPK-ja.

Në këto kushte, Komisioni e konsideron të plotë raportin dhe fton Këshillin ta miratojë.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.

Z. Ibrahim vijon me leximin e projektaktit si më poshtë:

Bazuar në nenet 149/a, 179/b, nenin “e” të Kushtetutës; nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit nr.115/2016 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; nenet 40 dhe 42 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”; neneve 71 dhe 94 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me raportin e rivlerësimit nga Komisioni i Veprimtarisë Etike dhe Profesionale për subjektin e sipërcituar, vendosi:

1. Miratimin e raportit për rivlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, për prokuroren Elsa Miha.
2. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. *(Vendimi i plotë ndodhet në dosjen e mbledhjes plenare si dhe i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).*

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e raportit për rivlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, prokurores Elsa Miha.

Miratohet me 8 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Drini Pali.*

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Balla, për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.



Z. Balla relatton, duke theksuar se tanimë Këshilli është bërë pjesë e procesit të vetingut dhe se, për hartimin e raporteve profesionale të rivlerësimit kalimtar për prokurorët, Komisioni bashkëpunon me gjashtë këshilltarë ligjorë (prokurorë) që punojnë pranë Këshillit. Edhe në rastin e prokurorit Pali, është ndjekur e njëjta procedurë si në rastet e sipërcituara. Janë marrë në shqyrtim tri dosjet e zgjedhura nga prokurori dhe pesë dosjet e përzgjedhura me short. Janë marrë parasysh të gjitha vërejtjet dhe ankesat e ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nga prokuroritë e rretheve.

Rezulton se ka një moment të ndërprerjes së ushtrimit të detyrës nga ana e këtij prokurori, por ai e ka rifituar te drejtën në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe aktualisht ushtron detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës. Komisioni vlerëson që, për këtë prokuror, nuk ka ndonjë masë apo gjetje negative thelbësore. Raporti u është shpërndarë anëtarëve në kohën e duhur dhe, në këto kushte, Këshilli është i ftuar ta miratojë, ashtu siç e ka paraqitur Komisioni.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.

Z. Ibrahim vijon me leximin e projektaktit sipas propozimit të Komisionit përkatës, si rast i njëjtë me rastin e mësipërm.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi si më poshtë:

1. Miratimin e raportit për rivlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, për prokurorin Drini Pali.
2. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. *(Vendimi i plotë ndodhet në dosjen e mbledhjes plenare si dhe i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).*

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektaktit.

Miratohet me 8 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikën e tretë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokuroren Rabiana Halili.*

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Balla, për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Z. Balla relatton, duke referuar faktin se Komisioni ka analizuar në mënyrë të hollësishme të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, përfshirë formularin e deklaramit, tre aktet e përzgjedhura nga



subjekti, pesë aktet e shortuara dhe të gjitha informacionet e ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nga prokuroritë e rretheve. Gjatë periudhës së rivlerësimit, kjo prokurore ka ushtruar funksionin në prokurorinë e rrethit Tiranë dhe atë të rrethit Fier. Meqenëse, periudhën më të gjatë kohore e ka patur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, shorti është hedhur në këtë prokurori. Në raport janë analizuar të gjitha ankesat, mosfillimet apo problematikat e ardhura nga institucionet përkarëse. Prokurorja Rabiana Halili ka filluar detyrën si prokurore, me Dekret të Presidentit të Republikës, në vitin 2002, dhe nga 2002-2007 ka ushtruar funksionin në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Fier; në vitin 2007, në Lushnje dhe, nga ky vit e në vazhdim, ushtron funksionin në prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Tetë dosjet janë analizuar dhe nuk ka ndonjë problematikë thelbësore. Prokurorja Halili ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm dosjesh, pasi është me një përvojë 18-vjeçare. Për këto arsye, ai fton Këshillin ta miratojë projektraportin siç e ka paraqitur Komisioni, duke mirëpritur ndërkohë, vërejtje apo propozime.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektaktit.

Miratohet me 8 vota pro.

(Vendimi i plotë për subjektin e rivlerësimit kalimtar, prokuroren Rabiana Halili, ndodhet në dosjen e mbledhjes plenare, si dhe i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Ibrahim vijon me pikën tetë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektaktit për mbarimin e statusit, për shkak dorëheqjeje, të magjistratit Nezir Gjoka, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë.*

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Beluri, për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Z. Beluri relatton, duke informuar se pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka ardhur kërkesa për dorëheqje nga prokurori Nezir Gjoka. Kjo kërkesë mban datën 02.06.2020 dhe është protokolluar me numër 688. Subjekti është aktualisht prokuror pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë. Kërkesa e tij është mbështetur në nenin 65, pika 3 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku thuhet se: “Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratimin e Këshillit, dorëheqja mund të jape efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”. Sipas të dhënave të përfutuara nga zyra e Burimeve Njerëzore, magjistrati Nezir Gjoka e ka filluar punën si prokuror më 30.12.1982, ndërsa e ka motivuar dorëheqjen e tij “për arsye shëndetësore”, shoqëruar me dokumentat përkatëse. Nisur nga parashikimet në pikën 2 dhe 3 të nenit 65 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe kërkesa e motivuar e magjistratit Nezir Gjoka, Këshilli duhet të deklarojë



mbarimin e statusit, përpara kohës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 65 dhe pikërisht në datën 30 Qershor 2020, që është dita e fundit e muajit në të cilin është depozituar në Këshill, kërkesa për dorëheqje. Në këto kushte, Këshilli ftohet për ta miratuar projektaktin për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak dorëheqjeje.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.

Z. Ibrahim vijon me leximin e aktit si më poshtë:

Bazuar në nenin 64, pika 1, germa “a”, nenin 65, pika 2 dhe pika 3 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenin 189, pika 1, germa “a” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me relacionin, vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes. Dorëheqja i jep efektet në datën 30.06.2020.
2. Të njoftohet për këtë vendim z. Nezir Gjoka, Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. *(Vendimi i plotë ndodhet në dosjen e mbledhjes plenare, si dhe i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).*

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektaktit.

Miratohet me 8 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikën e nëntë të rendit të ditës.

- *Hedhja e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit të përkohshëm, për shqyrtimin e ankesave lidhur me arkivimin e hetimit nga ana e ILD-së.*

Z. Ibrahim bën me dije që, bazuar në nenin 160, pika 13 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, për shqyrtimin e këtyre ankesave, parashikon mundësinë që ankuesit të ankohen kundër vendimit të ILD-së për arkivimin e ankesave, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Për këtë arsye, Këshilli duhet të ngrëjë një komision të përkohshëm, të përbërë nga dy anëtarë joprokurorë dhe një anëtar prokuror.



Kryetari i Këshillit propozon që ky komision të ngrihet sipas procedurës së parashikuar nga ligji, me short, dhe të veprojë deri në fund të vitit 2020, pra jo rast pas rasti. Këshilli pajtohet me këtë propozim dhe, për caktimin e anëtarëve të komisionit të përkohshëm, Kryetari propozon sërish që shorti të organizohet në zyrën e tij. Më pas, ai ndërpret mbledhjen plenare për arsye teknike, për t'u rikthyer pas 5 minutash.

Z. Ibrahim rihap mbledhjen plenare, duke vlerësuar idenë që Këshilli të ngrrejë një komision të përkohshëm, i cili do të duhet të veprojë deri në fund të vitit, pasi ankesat nga qytetarët priten të jenë të shumta, ndaj vendimeve të ILD-së, për arkivimin e ankesave të tyre. Sipas ligjit, komisioni duhet të përbëhet nga dy anëtarë joprokurorë dhe një anëtar prokuror. Teksa z. Ibrahim shpjegon procedurën, tre pjesëtarë të stafit zhvillojnë hedhjen e shortit në mënyrë transparente, nën vëzhgimin e kameras.

Z. Bazaj gjykon që anëtarët e Komisionit të Disiplinës duhet të përjashtohen nga ky short, duke cituar si argument, nenin 30, pika "c" të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative". Sipas tij, Këshilli ndodhet para një pengese ligjore, dhe këmbëngul se, si ai, ashtu dhe z. Sheshi, duhet të përjashtohen nga ky short, pasi nëse marrin pjesë në këtë komision të përkohshëm, ata nuk mund të jenë edhe pjesë e shqyrtimit të ankesave në Komisionin e Disiplinës, në cilësinë e vendimmarrësit, sërish në një proces administrativ.

Znj. Seiti sqaron, duke iu referuar statusit të saj, se ajo nuk është pjesë (anëtare) e Komisionit të Disiplinës, por thjesht në pozicionin e zëvendësueses, në kushtet aktuale kur ky komision ka në përbërje të tij vetëm dy anëtarë: një prokuror dhe një joprokuror.

Z. Ibrahim shpreh mendimin e tij të ndryshëm nga ai i z. Bazaj, me argumentin që detyra e komisionit të përkohshëm konsiston thjesht në formën e rishikimit të vendimeve të ILD-së, kur këto të fundit disponojnë për arkivimin e një hetimi. Këshilli mund të vendosë kundër vendimarrjes së ILD-së për arkivimin, dhe pasojë e drejtpërdrejtë e këtij vendimi, mund të jetë eventualisht ose rifillimi i hetimit, ose mbyllja e tij. Në këto kushte, kjo nuk do të thotë se paragjykohet qëndrimi i anëtarit të Këshillit, që është edhe anëtar i Komisionit të Disiplinës.

Z. Sheshi propozon që Këshilli të kalojë në votim për këtë çështje.

Z. Balla shprehet se Këshilli duhet të zgjedhë anëtarin e tretë të Komisionit të Disiplinës dhe interesohet, nëse ka ndonjë kandidaturë.

Z. Ibrahim i qëndron argumentit se Këshilli duhet të marrë një vendim, nëse anëtarët e Komisionit të Disiplinës duhet të përjashtohen nga komisioni i përkohshëm. Sipas tij, ligji nuk i përjashton dhe nuk ka arsye që anëtarët e Komisionit të Disiplinës të përjashtohen, apriori.

Megjithatë, Kryetari e hedh në votim, duke pyetur se kush është dakord që anëtarët e Komisionit të Disiplinës të mos përjashtohen nga shorti për t'u zgjedhur edhe në komisionin e përkohshëm?



Propozimi nuk miratohet, pasi merr 6 vota kundër dhe dy vota pro: Znj. Seiti dhe z. Ibrahim.

Për rrjedhojë, nga shorti në fjalë u përjashtuan paraprakisht anëtarët e Komisionit të Disiplinës, z. Bazaj dhe z. Sheshi.

Ndërkaq, si kandidatura për dy vendet e anëtarëve joprokurorë, mbetën z. Gent Ibrahim, z. Sandër Beci, z. Alfred Balla dhe znj. Nurihan Seiti. Nga shorti i zhvilluar mes këtyre katër emrave të kandidatëve joprokurorë, u përzgjedhën znj. Nurihan Seiti dhe z. Gent Ibrahim.

Më pas, u zhvillua shorti për një vend, mes tre emrave të kandidatëve prokurorë, konkretisht: znj. Esmeralda Keshi, z. Vatë Staka dhe z. Kostaq Beluri, prej nga u përzgjedh z. Kostaq Beluri.

Si përfundim, anëtarë të komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankesave kundër arkivimit të hetimit nga ana e ILD-së, janë z. Gent Ibrahim, znj. Nurihan Seiti dhe z. Kostaq Beluri.

Z. Ibrahim vijon me pikën e dhjetë të rendit të ditës.

- *Prezantimi i projekt-rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionet e drejtuesit të prokurorisë”.*

Z. Ibrahim vë në dukje se, përsa i përket kësaj pike të rendit të ditës, komisioni nuk ka pasur mundësi ta finalizonte projekt-rregulloren, por siguron se ajo do të përfundohet së shpejti.

Këshilli vendosi se diskutimet mbi projekt-rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionet e drejtuesit të prokurorisë”, të kalojnë për mbledhjen e ardhshme.

Z. Ibrahim vijon me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

- *Raportimi nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale për ecurinë e procesit të verifikimit të figurës, pasurisë si dhe plotësimit të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga ligji, për kancelarët në detyrë në sistemin e prokurorisë si dhe për kandidatët për inspektorë në ILD.*

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Balla, për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Z. Balla relatton duke sqaruar se, për pozicionin e inspektorit pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë kandiduar gjashtë magjistratë prokurorë, si më poshtë:

1. Elena Pelushi (Bakallbashi);



2. Lindita Ziguri (Male);
3. Julian Zonja;
4. Xhevahir Lita;
5. Daniela Sulaj (Konica);
6. Sonila Muhametaj (Domi).

Është zhvilluar shorti dhe Komisioni u ka dërguar kërkesat përkatëse të gjithë organeve kompetente, sipas kërkesave të parashikuara në ligj. Ndonëse periudha tremujore e pandemisë ka ndikuar në këtë proces, Komisioni ka ndjekur të njëjtën procedurë.

Deri tani, Komisioni ka marrë përgjigje të pjesshme dhe është në pritje që të plotësohen dosjet përkatëse, për të dalë në një raport përfundimtar.

Z. Balla vijoi me paraqitjen e raportit për ecurinë e procesit të verifikimit të figurës, pasurisë, si dhe të plotësimit të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga ligji, për kancelarët në detyrë në sistemin e prokurorisë, si dhe për kandidatët për inspektorë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD).

Me Vendimin nr. 37, datë 05.02.2020 “Për plotësimin e katër pozicioneve pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes procedurës së komandimit të prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka shpallur fillimin e procedurave për plotësimin e katër pozicioneve për inspektorë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në përfundim të afatit të caktuar, më datë 19.02.2020 kanë kandiduar për këto pozicione, gjashtë magjistratët prokurorë të përmendur më lart.

Me Vendimin nr. 55, datë 24.02.2020 “Për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës të magjistratëve, kandidatë për t’u komanduar si Inspektorë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka filluar procedurën administrative për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë shprehur interes për t’u komanduar në pozicionet në fjalë.

Ndërkohë, lidhur me çështjen e kancelarëve në detyrë, me Vendimin nr. 56, datë 24.02.2020 “Për kryerjen e verifikimit të figurës, pasurisë, si dhe plotësimit të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga ligji për kancelarët në detyrë”, i ndryshuar me Vendimin nr. 79, datë 04.03.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka shpallur fillimin e procedurave të verifikimit të figurës, pasurisë dhe plotësimit të kushteve dhe procedurave sipas parashikimeve të ligjit për Shërbimin Civil.

Z. Balla informoi se, aktualisht, në sistemin e prokurorisë janë të punësuar në detyrën e kancelarit të prokurorisë, katër nëpunës civilë, konkretisht pranë prokurorive të Gjykatës së Shkallës së Parë në: Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Korçë.



Z. Ibrahim sqaron arsyen e tij për ta futur këtë çështje në rendin e ditës, me argumentin e presionit nga insitucionet përkatëse, kryesisht nga ILD, prandaj fton Këshillin t'i japë zyrtarisht një përgjigje këtij shqetësimi.

Ai sjell në vëmendje të Këshillit, se periudha tremujore e pandemisë dhe natyra e gjatë dhe e komplikuar e kësaj procedure kanë ndikuar në ecurinë e saj. Gjithësesi, ai konstaton që një pjesë e mirë e punës është bërë dhe mbetet vetëm hartimi përfundimtar i raportit.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.

Z. Ibrahim vijon me pikën e fundit të rendit të ditës.

- *Diskutimet rreth mundësisë për transferim të përkohshëm të një prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Pogradec; si dhe një prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës.*

Z. Ibrahim njofton se Këshilli ka administruar kërkesa me shkrim nga drejtuesit e prokurorive të Kukësit dhe Pogradecit, të cilët kërkojnë alokimin e burimeve njerëzore pranë këtyre zyrave, për shkak të ngarkesës së punës, e cila është e lartë dhe joproporcionale, krahasuar me ngarkesën e punës në prokuroritë e rretheve të tjera.

Këshilli ka përdorur, deri tani, vetëm instrumentin e caktimit të përkohshëm, ndërsa tani po merr në konsideratë edhe shqyrtimin e instrumentit të transferimit. Ai sqaron se, këto kërkesa ia ka paraqitur Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, dhe nisur nga ky fakt, Këshilli mund të aktivizojë për herë të parë një instrument siç është ai transferimit. Ndërkaq, Komisioni i Karrierës e ka gjykuar të nevojshme që kjo të ishte pjesë e një diskutimi paraprak në Këshill, para se të dilej me një vendim.

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Sandër Beci, për të relatuar në emër të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Z. Beci relatton se, Komisioni i ka marrë në shqyrtim këto dy raste, duke sqaruar se situata në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë-Pogradec, është emergjente për shkak se njëri nga prokurorët ka dhënë dorëheqjen, kurse ish-drejtuesi i kësaj prokurorie u ngrit në detyrë, duke u emëruar në strukturën e Prokurorisë së Posaçme. Nga katër prokurorë që ishin në organikë, aktualisht ushtrojnë detyrën vetëm dy të tillë. Duke patur parasysh që kjo situatë është dhe do të jetë afatgjatë, Komisioni vlerëson që t'i drejtohet institutit të transferimit.

Konkretisht, Komisioni ka kontaktuar me një magjistrat prokuror të ri, të emëruar në prokurorinë e Korçës, si dhe me Drejtuesen e kësaj prokurorie. Është marrë pëlqimi paraprakisht dhe shprehur



vullneti i tij për t'u transferuar, sikundër dhe është siguruar miratimi i titullares së prokurorisë së Korçës.

Në bazë të nenit 46, pika 1, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet që Këshilli, fillimisht, duhet të përdorë instrumentin e delegimit, dhe në mungesë të tij, mund t'i kërkojë magjistratit transferim të përkohshëm, duke marrë parasysh si pëlqimin e subjektit, ashtu dhe miratimin e titullarit.

Në rastin e Pogradecit, Komisioni e konsideron të zgjidhur, por nevojitet formalisht dhënia e pëlqimit nga ana e titullarit të prokurorisë së Korçës, si dhe pëlqimi i prokurorit.

Përsa i takon rrethit të Kukësit, Komisioni ende nuk e ka marrë në shqyrtim problemin, pasi ka konsideruar më emergjent rastin e Pogradecit. Megjithatë, edhe Kukësi do të merret në konsideratë, sikurse dhe kërkesat e drejtuesve përkatës të prokurorive të tjera.

Z. Ibrahim sqaron se, këto diskutime janë me vlerë, sepse janë një parapërgatitje, para se Këshilli të dalë në projektvendime të mirëfillta.

Z. Beluri saktëson se, lidhur me rastin e prokurorit të ri të Korçës, nuk është se ai ka dhënë pëlqimin për transferim, por thjesht ka treguar bindjen e tij, pasi edhe sipas parashikimeve ligjore, ai është personi konkret dhe më i përshtatshëm, transferimi i të cilit mund të aplikohet edhe pa iu marrë pëlqimi, pasi bëhet fjalë për prokurorin më të ri në prokurorinë me ngarkesë të ulët në punë. Ndërkohë, edhe drejtuesja e prokurorisë së Korçës konfirmon se transferimi i tij nuk ndikon në ecurinë e punës së kësaj prokurorie.

Gjithësesi, Komisioni do të vijë me një projekt-vendim konkret në mbledhjen e ardhshme plenare, ku edhe Kukësi duhet të trajtohet me përparësi, pasi, krahasuar me Tropojën, prokuroria e kësaj të fundit ka një ngarkesë pune më të ulët se i pari.

Z. Ibrahim shprehet se, ky diskutim është një "dritë jeshile" për Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, për të ndërmarrë procedurat e nevojshme, duke kryer verifikimet e duhura në terren dhe hartuar projektaktet përkatëse për mbledhjet e ardhshme.

Në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)



KRYETAR

Gent Ibrahim



Shënim:

Në përmbledhjen e këtij procesverbali prej 17 (shtatëmbëdhjetë) faqesh, janë/nuk janë pasqyruar pasaktësitë e mundshme, të konstatuara nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të Kryetarit, Nr. — Datë — 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Nr. — datë — (bashkëlidhur, kopjet e dokumenteve).

Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë 26/06/2020.

Procesverbali të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi

